




REPUBLIKA E SHQIPËRIË  
MINISTRIA E DREJTËSISË

## NJOFTIM PËR SHTYP

2017-11-13 19:51:00



Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 8678, datë 14.05.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", i ndryshuar, të neneve 13, 14 dhe 19, të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012, "Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme", i ndryshuar, Vendimit nr.173, datë 7.3.2003 "Për emërimin, lirin ose shkarkimin nga detyra të drejtuesve të institucioneve, në varësi të Këshillit të Ministrave, Kryeministrit ose të Ministrit", të Urdhrit të Ministrit të Drejtësisë nr. 6323/2, datë 25.10.2017 "Për miratimin e rregullores për përcaktimin e rregullave, procedurave dhe afateve të organizimit të testimit të regjistruarit të zyrave vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme", si dhe me qëllim rekrutimin dhe emërimin e regjistruarve të rinj bazuar në procedura transparente të konkurrimit publik, dhe kriteret që mbështesin parimin e meritokracisë,

**Ministria e Drejtësisë shpall konkursin e hapur për pozicionin "Regjistruar" të Zyrave Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, përkatësisht në:**

1. ZVRPP Berat
2. ZVRPP Bulqizë
3. ZVRPP Devoll
4. ZVRPP Dibër
5. ZVRPP Durrës
6. ZVRPP Elbasan
7. ZVRPP Fier
8. ZVRPP Gjirokastrë
9. ZVRPP Gramsh
10. ZVRPP Has
11. ZVRPP Kavajë
12. ZVRPP Kolonjë
13. ZVRPP Korçë
14. ZVRPP Krujë
15. ZVRPP Kuçovë
16. ZVRPP Kukës
17. ZVRPP Kurbin
18. ZVRPP Lezhë
19. ZVRPP Librazhd
20. ZVRPP Lushnjë
21. ZVRPP Malësi e Madhe
22. ZVRPP Mallakastër
23. ZVRPP Mat
24. ZVRPP Mirditë
25. ZVRPP Peqin
26. ZVRPP Përmet
27. ZVRPP Pogradec
28. ZVRPP Pukë
29. ZVRPP Sarandë
30. ZVRPP Shkodër
31. ZVRPP Skrapar
32. ZVRPP Tepelenë
33. ZVRPP Tiranë
34. ZVRPP Tropojë
35. ZVRPP Vlorë

## KUSHTET LIGJORE PËR EMËRIMIN E REGJISTRUESIT

1. Kandidatët për pozicionin "Regjistruar" në ZVRPP duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme:



- a. të jetë shtetas shqiptar;
- b. të ketë mbaruar arsimin e lartë juridik, ekonomik, inxhinierik ose menaxhim publik;
- c. të ketë përvojë pune jo më pak se 5 vjet në administratën publike;
- d. të ketë specializime në fushën e vlerësimit të pasurive të paluajtshme;
- e. të mos ketë qenë i dënuar penalisht;
- f. të mos ketë konflikt interesi.

## DOKUMENTACIONI PËR APLIKIM

1. Kandidatët që aplikojnë për pozicionin “Regjistruer” duhet të dorëzojë dokumentet si më poshtë:
  - a. [Kërkesën që specifikon Zyrën/Zyrat vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për të cilat po aplikohet;](#)
  - b. [Jetëshkrimi i plotësuar;](#)
  - c. Fotokopje e diplomës së arsimit të lartë dhe listës së notave;
  - d. Fotokopje e kartës së identitetit ose e pasaportës;
  - e. [Formularin e vetëdeklarimit për garantimin e integritetit të personave që ushtrojnë funksione publike, të plotësuar elektronikisht dhe të nënshkruar, sipas linkut](#)
  - f. Dy referenca nga punëdhënësi të mëparshëm;
  - g. [Autorizimin me shkrim për të lejuar Ministrinë e Drejtësisë të bëjë verifikimin e gjendjes gjyqësore;](#)
  - h. [Deklaratën që kandidati nuk është në kushtet e konfliktit të interesit;](#)

2. Dokumentet e mësipërme duhet të dorëzohen elektronikisht në adresën elektronike: [konkurrimi.publik@drejtesia.gov.al](mailto:konkurrimi.publik@drejtesia.gov.al) ose me postë në adresën: Ministria e Drejtësisë - “Bulevardi Zogu i I-rë”, Tiranë.

**Afati i dorëzimit të aplikimeve është data: 14 Nëntor 2017**

### TESTIMI I AFTËSIVE

Vlerësimi i kandidatëve që plotësojnë kriteret e përgjithshme do të kryhet në përputhje me procedurat e testimit të miratuara me Urdhrin e Ministrit të Drejtësisë nr. 6323/2, datë 25.10.2017 “Për miratimin e rregullores për përcaktimin e rregullave, procedurave dhe afateve të organizimit të testimit të regjistruerit të zyrave vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme”.

Data dhe vendi ku do të zhvillohet konkurrimi si dhe programi i testimit, do të publikohen në vijim në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë.